

**Ambasadori Christopher Hill vlerësoi se nga të gjitha NGO-të që ai njeh, nuk ka asnjë më rezultative në vendosjen e urave të bashkëpunimit midis shteteve e popujve, se sa Rotary Ndërkombëtar.**

# Konferencë

**Klubi i parë Rotary në Shqipëri u themelua më 1992 dhe sot në vend vepron pesë klube të tilla. Gjithashtu, është themeluar një klub "Rotarakt" (klubi i të rinjve) dhe një klub "Rotary Innerwheel"**

## Rotarianët diskutojnë të ardhmen e rajonit

Nën organizimin e klubeve Rotary nga Ballkani, në Ohër u organizua Konferenca "E Ardhmja e Rajonit." Në konferencë u përfaqësuan klube Rotary nga vendi organizator Maqedonia, si edhe nga Austria, Shqipëria, Kosova, Bullgaria, Turqia, Serbia, Mali i Zi, etj. Bashkë me shumë personalitete të rëndësishme nga grupimet e klubeve Rotary të Ballkanit, në konferencë morën pjesë edhe Kryetari i Rotary Ndërkombëtar (2011-12) Kalyan Banerjee, Dr. Srgjan Kerim nga Turqia, i cili ka qenë President i Asamblesë së Kombeve të Bashkuara 2007/2008, si dhe personalitete të spikatura me histori të gjatë angazhimi në Ballkan si Christopher Hill dhe Erhard Busek. Në fjalën e tij hyrëse Koordinatori i "Southwest European Cooperative Initiative" (SECI), z. Busek, theksoi rëndësinë e BE-së për zhvillimin e rajonit dhe argumentoi se rritja e tregëtisë mes shteteve ballkanike dhe forcimi ekonomik ndikon edhe në rritjen e stabilitetit. Ai theksoi se integrimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE nuk kalon vetëm nëpërmjet Brukselit, por edhe përmes kryeqyteteve të shteteve anëtare të BE, dhe në këtë këndvështrim roli i mar-



rëdhënieve midis klubeve Rotary ballkanike dhe europiane është shumë i rëndësishëm. Ambasadori Christopher Hill vlerësoi se nga të gjitha NGO-të që ai njeh, nuk ka asnjë më rezultative në vendosjen e urave të bashkëpunimit midis shteteve e popujve, se sa Rotary Ndërkombëtar. Duke folur për të ardhmen e rajonit, ai tha se tani nuk mjafton të bindim Gjeneralin Klark të vijë tek ne, por na duhet që të bindim Gjeneralin Motors! Ai vlerësoi se i takon sektorit privat, ku rotarianët janë shumë aktivë, që të zhvillojë ekonominë dhe të

uli papunësinë. Anëtarë të Këshillit të Përgjithshëm të Bankës Kombëtare të Austrisë, Prof. Dr. Bernhard Felderer, njihës shumë i mirë i investimeve Austriake në Ballkanin Perëndimor dhe njeri nga ekonomistët më të kuotuar europianë të sotëm, paraqiti një analizë shterruese të pikave të forta e të dobëta të ekonomive të vendeve të këtij rajoni. Në përfundim të konferencës, midis Bordit të Klubeve Rotary të Shqipërisë dhe Distriktit Rotary të Bullgarisë u firmos një marrëveshje e veçantë bashkëpunimi, për shkëmbime në

fusha me interes të përbashkët. Klubet Rotary janë klube shërbi mi që kanë për synim të bashkojë liderët e bizneseve dhe profesioneve me qëllim dhënien ndaj komuniteteve të tyre dhe me gjerë të shërbimeve humanitare, nxitjes së standardeve të larta etike në të gjitha fushat dhe ndihmesës për forcimin e paqes në botë. Rotary Ndërkombëtar është shoqa-

ta e klubeve Rotary të të gjithë botës, e themeluar në vitin 1905 në Çikago. Ajo është një organizate laike, e hapur për antarësim pavarësisht nga racat, ngjyrat, prejardhjet, fetë, gjinitë dhe përkatësitë politike. Në botë ka 34,282 klube dhe mbi 1.2 milionë anëtarë. Klubi i parë Rotary në Shqipëri u themelua më 1992 dhe sot në vend vepron pesë klube të tilla. Gjithashtu, është themeluar një klub "Rotarakt" (klubi i të rinjve) dhe një klub "Rotary Innerwheel". Që të gjithë sëbashku kanë vënë në jetë shumë projekte humanitare si vaksinimi i të porsalindurve nga hepatiti B, ndihma humanitare ndaj refugjatëve kosovare gjatë bombardimeve në Kosovë, ndihma për të dërguar fëmijë jashtë vendit për të kryer operacione të zemrës, përmirësim të furnizimit me ujë nëpër shkolla e fshatra të largëta, pajisje e spitaleve publike me teknologji bashkëkohore për diagnostifikim dhe trajtim të sëmundjeve të ndryshme etj.

## Guida e Tiranës në duart e operatorëve turistikë

Bashkia e Tiranës ka prezantuar Guidën Turistike të Tiranës, e cila është tashmë në duart e operatorëve turistikë. Në këtë guidë në gjuhën angleze, turistët do të mund të gjejë informacionin e nevojshëm gjatë qëndrimit në Tiranë. Pak histori për kryeqytetin, vendet që duhen vizituar dhe monumentet që duhen parë, hotelet, restorantet, qendrat tregtare, aktivitetet kulturore, kinematë, teatrot dhe një hartë e qytetit. Kryebashkiaku Basha ka shprehur vendosmërinë e Bashkisë së Tiranës, për të investuar në objekte të trashëgimisë historike dhe kulturore, të cilat janë lënë prej vitesh në harrësë por që janë mjaft tërheqëse për turistët. "Në emër besoj të shumë përfaqësuesve të shoqatave turistike, agjencive të udhëtimit, agjencive turistike të cilat kanë disa kohë që janë bërë me dy kalime. Deri para pak kohësh organizonin dhe së fundmi me shumë sukses, pas heqjes së vizave, ture për shqiptarët jashtë ndërsa siç po shikojmë nga dita në ditë, gjithnjë e më shumë vizitorë dhe turistë po i drejtohen vendit tonë, po i drejtohen Tiranës. Tiranë ka shumë për të ofruar dhe angazhimi im, që në fillim të marrjes së detyrës si kryetar i Bashkisë, ishte që Tirana të mos mbetej një pikë automatike e itinerarit të vizitorëve që vinin për të shijuar për shembull bregdetin apo malet, apo destinacionet e vjetra historike si Kruja, Berat, Shkodra por të kthehet në një destinacion të mirëfilltë turistik. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me një ambicje apo me një dëshirë të lidhur me bukuritë poetike të Tiranës të cilat ju sapo i referuat, z. Zhiiti. Kjo ka të bëjë me një objektivi shumë konkret, me krijimin e mundësive që turizmi në Tiranë të dyfishohet si industri deri në vitin 2015 apo thënë më

shkoqur që deri më 2015, industria e turizmit, përmes aktivitetit të saj në Tiranë të mundësojë hapjen e jo më pak se 20 mijë vendeve të reja të punës, në vetë sektorin e saj dhe në të gjithë pjesët e tjera që tërheq pas zinxhir, restorantet, hoteleri, biznesin e vogël, dyqanet e shumë të tjera. Ky është sot një objektivi shumë i arritshëm dhe ne kemi parë se si në qytet prej disa muajsh kanë filluar ture grupe turistësh nga Skandinavia, Kina, Japonia, Koreja, Amerika e Veriut dhe vende të tjera të BE. Sot, me këtë instrument ne u vijmë në ndihmë dhe bëjmë detyrën tonë si Bashki e Tiranës duke u ardhur në ndihmë këtyre operatorëve turistikë, për të bërë të mundur një organizim më të mirë të itinerarit turistik të Tiranës. Është një itinerar që dy vitet e fundit është thuhajse trefishuar, p.sh me nxjerrjen në pah të vlerave historike, si këtu ku jemi ulur, themelet e vjetra të Kalasë së Tiranës apo tek Mozaiku i Tiranës por edhe me ndërtime të reja të tjera të referencës, siç është Memoriali i Shqiponjës, Memoriali i Shpalljes së Pavarësisë, Memoriali Post-Bllok dhe shumë e shumë pika të tjera të investuara edhe me rastin e 100 vjetorit të Pavarësisë, por që ju siguroj, nuk do të mbetemi këtu. Kemi plane dhe kemi futur tashmë në rrugën e investimit projekte të tjera të rëndësishme. Këtu ku ndodhemi, prapa nesh, prapa këtij muri ndodhet një kompleks që ka mbetur vetëm në fotot e vjetra historike apo në memoriet e pak qytetarëve që e kanë vizituar ndoshta për herë të fundit, 10-15 apo 20 vite më parë (nuk e di sa prej nesh e kanë vizituar dy vitet e fundit, kush e ka vizituar dy vitet e fundit, le të ngrejë dorën). Unë e kam vizitu-

ar për projektin por me sa shoh askush tjetër. Ka një arsye për këtë, pasi këtu ku ndodhet në fakt edhe kërthiza e Tiranës historike, të ashtuquajtura, kompleksi i kalasë së Toptanasve. Ne kemi në plan të rehabilitojmë plotësisht zonën historike, duke mundësuar që të gjithë objektet me vlerë historike të jenë të aksesueshme për publikun, t'i shërbejnë publikut përmes shërbimeve të tilla si kafe, restorant, dyqane souvenieresh por jo vetëm kaq! Në bashkëpunim me pronarët dhe me investimin e Bashkisë së Tiranës, ne do të rindërtojmë aty me të gjithë parametret më besnike të Institutit të Monumenteve të Kulturës një qendër të re e cila do të jetë e re për qytetin por do të jetë shprehëse e vlerave më autentike të kryeqytetit dhe do krijojë në vetvete mundësitë për punësimin e jo më pak se 500 qytetarëve të Tiranës. Pra, kjo pedonale do të kthehet jo thjesht në një shëtitore por në një rrugë që të çon diku, pikërisht tek kërthiza e këtij qyteti dhe mundëson përmes këtij itinerari pasurimin e shumëllojshëm të ofertës sonë turistike. Për më tepër këto projekte të tjera, rehabilitimin e sheshit "Avni Rustemi" i cili edhe sot ka një vlerë të kufizuar për qytetin por me projektin që ne do të vëmë në lëvizje me fondet e Bashkisë dhe qeverisë shqiptare do ta kthejmë në një pikë me po kaq vlerë për industrinë turistike. Ne do të pasurojmë me të tjera artefakte kulturore, artistike, monumentale, historike, çdo pjesë të kryeqytetit tonë dhe investimet që sot po shtrihen anembanë infrastrukturës (përmend këtu edhe bulevardin e ri) do të kenë si pjesë integrale të zhvillimit të tyre edhe itinerarin paisazho-turistik të këtyre investimeve".

## Inderuar politikani im BOS

**Kastriot Haxhiu**

Duke marrë shkas nga një intervistë që ke dhënë në një nga televizionet në Tiranë po ju drejtohem Juve. Këtë po e bëj, jo, për tu vënë në pozitë, as për të bërë polemikë me Ju si person, por nga respekti që kam si atdhetar, manaxher, biznesmen dhe së fundi si politikan. Unë jam Financier, jo në moshë shumë të re, dhe me një ekperiencë jo të vogël në zana. Të më falësh po qe se kuptoi mirë politikën e madhe.



Atdheu ynë, miku im, në të gjitha kohrat ka patur Atdhetarë të mëdhenj që kanë sakrifikuar çdo gjë, që kishin për atdheun tonë, ashtu siç ka patur dhe Tradhtarë të mëdhenj që nuk janë ngopur për ti marrë dhe lekurën dhe kanë bërë pazare për çdo gjë që ka patur dhe prapë të tilla do të ketë.

Në rrethet tona shoqërore vazhdimisht është folur për njerëz tepër të suksesshëm në botë: për biznesmenë të mëdhenj, artiste të mëdhenj, shkencëtarë të mëdhenj, studente shumë të mirë që kanë ngritur flamurin tonë kudo dhe kanë thënë me plot gojë që janë Shqiptar.

Më kanë pëlqyer vazhdimisht qendrimit humane që kini mbajtur për atdhetarët tanë kudo ku janë dhe me pëlqejnë inisiativat tuaja dhe për kohën si politikan-megjithëse kanë ngelur në zyrat dhe janë portokolluar të gjitha sipas rregullave të shtetit për ti treguar historia. Të jeni të bindur se dhe media kanë bërë punën e vet.

Të gjithë në fshat të mbajnë në gojë dhe në oda burrash përmëndesh se kur erdhe në dasmën e vëllait tënd hodhe një tujë me lek për ahengxhinjtë dhe sa bukur u bë gjithë sheshi (me Euro) kur kërceje ti, miku im, por mbrapa përfundoi si Torta në Tiranë. Megjithatë, patrioti im, atdheun tonë nuk e bashkojnë portokollat dhe lobingjet. Atdheun tonë e bashkon dhe e bën të pavarur Ekonomia. Ju kapitali i kini tuajat, nuk ja keni vjedhur kur-

rkujt. I ke fituar me djersë dhe jo radhë here dhe me gjak. Por është koha ta tregosh veten që je patriot, që e do kombin tënd, që e do të bashkuar, por jo duke folur se i shton fukarallëkun, por duke investuar Miku im.

Nëna jonë e madhe, miku im, të dha inteligjencën, zgjuarsinë, dinjitetin, personalitetin dhe puna jote të bëri BOS.

Shikoje, vella! yt po shet tokën se do shkollojë fëmijët, të gjitha ato që prodhon (dhe jo pak) nga toka po shkojnë dëm se duhen ca investime për ti konservuar, etj. Tjetri po e shet se i ka ngelur djerrë dhe s'ka kapitale për të bërë një pentari që frutat e saj ti nxjerrë në treg. E mban mend kur shkonim te daja dhe na tregonte për atë gurin e bukur që e merrin austrohungarezet për vilat e arhondeve, tani e shfrytëzon një shoqëri e huaj (serbo-kroate-angleze-greke e ku di unë nga janë). The që do krijoje një bankë shqiptare që të na ndihmonte. Byrazerit të babës po ja merr tokën banka (serbo-kroate-angleze-greke e ku di unë nga janë) se nuk i ka shlyer këstin e kredisë. Bankës tënde do t'ja jepte me qef.

Më fal se të besdisa shumë por ti e di se nuk rrija dot pa treguar të rejtat nga fshati. Më fal se desh harova. Na erdhi mbas darke një nga fëmijët dhe na kërkoi të të bënim një letër dhe të pyesnim ty (se ty të kemi për mend), se çfarë gjuhe të huaj duhet të mësojnë djemtë për tu futur në punë këtu në vendin tonë. Kesaj radhe po të shkruaj shkurt, por radhës tjetër do ti marr një nga një.

Të fala të gjithë patriotëve. Ti i ke krijuar të gjitha. S'ke më nevojë të punosh.

## Bankat kanë kapitale për të përballuar rreziqet

Sipas Bankes së Shqipërisë, gjatë vitit 2012, kredia me probleme është rritur me rreth 23.7 miliardë lekë. Ritmi i rritjes së kredisë me probleme ka qenë më i lartë se ritmi i rritjes së tepricës së kredisë së sistemit bankar, e si rrjedhojë evidentohet rritje e treguesit të cilësisë së portofolit të kredisë "kredi me probleme ndaj tepricës së kredisë të sistemit bankar" me rreth 3.7 pikë përqindje, duke arritur në rreth 22.5%. Në fund të vitit 2012, treguesi "Kredi me probleme/Tepricës së kredisë (neto)", rezultoi në rreth 11.56% nga niveli 10% i një viti më parë. Analiza e strukturës së portofolit të kredisë sipas klasave të cilësisë, evidenton rënie të peshës së kredive cilësore kundrejt rritjes së peshës të kredive me probleme. Në fund të vitit 2012. Në portofolin e kredive cilësore, evidentohet rënie e kredive të klasifikuara "standarde" dhe rritje e lehtë e peshës së kredive të klasifikuara "në ndjekje". Ndërkohë, në portofolin e kredive me probleme, evidentohet rritje e peshës për të tre klasat...

(Faqe 5)



## Leje qëndrimi për të huajt, tipi "A", "B" dhe "C"

(Faqe 6)



## Berisha: Legalizim brenda këtij viti me çmime të reja

Kryeministri Berisha inauguroi dje rikonstrukcionin e rrugës së "Dibrës", në Tiranë, një investim bashkëkohor me vlerë 98 milionë lekë. Krahas ndërhyrjes në ndërtimin e sistemit të kanalizimeve dhe vendosjen e 112 copë ndriçuesve rrugorë, në këtë rrugë janë mbjellë

edhe 350 fidanë bliri dhe janë hapur vende parkimi për automjete. Rruga e "Dibrës" do të jetë arterie kryesore e qytetit, në kuptimin e transportit publik dhe në veçanti, të parapërgatitjes për projektin e tramit, një ndër arteriet e rëndësishme të linjës...

(Faqe 3)

## Ligje ka, por ato nuk zbatohen

Fushata elektorale është mjaft zhgënjyese, sa i takon pjekurisë demokratike. Kemi thujse 70 parti që kandidojnë, dhe 62 prej tyre janë të lidhura me një nga dy blloqet, kështu që kemi një fushatë elektorale dy partish, ose blloqesh, mes të cilave ndryshimet nuk janë edhe aq ideologjike, se sa në luftën për pushtetin dhe privilegjet e lidhura me të. Nga ajo që kemi vëzhguar deri tani

mund të themi që fushata nuk është përqëndruar edhe aq në temat elektorale se sa tek fajësimet reciproke, si akuzat për korrupsion, nga të cilat thujse çdo ditë dëgjojmë të reja. Shumë prej tyre mund të jenë të ekzagjeruara, por një pjesë janë të mbështetura nga prova, qofshin këto akuzat për sulme ndaj zyrave, apo ndaj kandidatëve.

(Faqe 4)

### Energjetikë

## Fluxys, interes i lartë për t'iu bashkuar projektit TAP

Grupi evropian i infrastrukturës së gazit Fluxys po merr në konsideratë të bëhet aksioner në projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP). Diskutimet ndërmjet aksionerëve të Fluxys dhe TAP nisën në vitin 2012. Këto negociata po vazhdojnë me pikësynimin për përfshirjen e Fluxys si aksioner i projektit TAP shumë shpejt pasi Konsorciumi i Shah Denizit të ketë marrë vendimin mbi alternativën e parapëlqyer evropiane për të sjellë gazin nga Azerbajxhani. Fluxys është një operator madhor i tranzitit



të gazit në Evropë, duke ushtruar aktivitete në gjashtë vende dhe është

gjithashtu një nga operatorët e paktë që kombinon transmetimin...

(Faqe 4)

## KLSH dhe bota akademike



Dje, KLSH lidhi marrëveshje bashkëpunimi me Fakultetin e Gjeologji-Minierave. Në këtë klimë të ndezur të garës zgjedhore, kjo ngjarje kuptohet ka kaluar pa shume vemendje. Por rëndësia e saj në nivel të cilësisë së auditimit suprem tek ne është paresore. Që ne nendor 2011, Kryetari i sotëm i KLSH, atehere kandidat, kishte parashikuar në platformën e tij intensifikimin e bashkëpunimit me ekspertët universitarë dhe akademikë...

(Faqe 5)

### Rajon

## Samaras: Reformat nuk do të ndërpriten

"Dilema nuk është se kujt se kujt do t'i faturohen zgjedhjet e parakohshme, por cilit do t'i faturohet ngrirja e reformave", theksoi kryeministri Antonis Samaras, duke folur në konferencën përgatitore të kongresit të Demokracisë së Re, në Nafplio. "Fati i Greqisë ka ndryshuar. ERT nuk është arsyeja, nuk është shkak, as edhe problemi, por preteksti për të ndaluar reformat", shtoi kryeministri. Antonis Samaras nëvizi se "Nuk mbështes pushimet masive nga puna në sektorin publik, por qoftë dhe disa largime duhet të bëhen edhe në këtë sektor. Demokracia nuk shantazhohet. Vala e reformave nuk ndërpritet.

(Faqe 9)



## Meta: Shqipëria meriton të shkëputet nga harresa

Kryetari i Lëvizjes Socialiste për Integrim, Ilir Meta, ka zhvilluar takime mjaft entuziaste me mijëra banorë të Këlcyrës, Përmetit dhe të Tepelenës, takime në të cilat

ka prezantuar ekipin e kandidatëve për deputetë të LSI-së në Qarkun e Gjirokastrës. Në këtë takime z.Meta ka shprehur "kënaqësinë e veçantë që vetëm një javë...

(Faqe 2)

Kurset e këmbimit të valutave kryesore kundrejt dollarit amerikan

Banka e Shqipërisë Dt.15.06. 2013

### Kurset e këmbimit

USD/lek	105.96
Euro/lek	141.30
GBP/lek	166.51
CHF/lek	114.78

### Interesat

Depozitat një ditore	4.50 %
Kredia lombard	12.25 %
Kredia një ditore	8.00 %
Marrëveshje riblerje	6.25 %



# Aktualitet



## Rama: Të çlirojmë vendin nga varfëria



Duke folur nga Librazhdi, në takimim përmblyllës të fushatës në këtë zonë të Shqipërisë, kreu socialist theksoi se më 23 qershor, shqiptarët duhet të votojnë PS për të çlirojmë vendin nga varfëria, nga pasiguria dhe nga pushteti i Kryeministrit Sali Berisha. "Votoni numrin 29 që Qeverinë ta keni në krah. Ju premtoj se ne do të jemi zëri juaj, fuqia e shpresave tuaja, do të jemi aleatët tuaj besnikë në përpjekje për të zgjidhur hallet dhe problemet e panumërt që keni", tha Rama. Kryesocialisti premtoi se do të ketë Rilindje të Librazhdit, do të ulen çmimet e ushqimeve, do të ulen taksat, do të përmirësohet jeta e banorëve, do të legalizohen ndërtesat informale, do të jepet certifikatat

e pronësisë së tokës. Kryetari i Partisë Socialiste Edi Rama, në mitingun përmblyllës në Peqin, i ftoi banorët e kësaj zone, por edhe të gjithë Shqipërisë që me votën e tyre të nxjerrin vendin nga tuneli i mungesës së shpresës. "Modeli i Partisë Socialiste është ai i zhvillimit të vendit. Prania juaj e shumë të numër këtu tregon se mbështesni rilindjen", tha Rama. Kryesocialisti Rama u kërkoi qytetarëve të refuzojnë blerjen e votës dhe të përqafojnë ëndrrën e rilindjes. "Refuzojni me përbuzje ata që ju trokasin tek dera për të blerë

me miell, për të blerë me euro, për të blerë me kalljen e frikës 4 vitet e tjera mbi kurrizin tuaj. E pra hiqini ata nga kurrizi flakini dhe përqafoji ëndrrën e rilindjes duke shkuar në 23 qershor dhe duke vendosur fundin e rrënim-it dhe fillimin e rilindjes. Ne ju zotohemi se me votën tuaj te numri 29, ju do të çlirohemi nga një zgjedhës varfëruese dhe poshtëruese dhe do të na keni në krah në të mirë dhe në të keq. Do të jemi me ju, hallet tuaja do të jenë tonat, përpjekjet tuaja do të jenë të përbashkëta. Rilindje" shtoi Rama

### Meta: Shqipëria meriton të shkëputet nga harresa

Kryetari i Lëvizjes Socialiste për Integrim, Ilir Meta, ka zhvilluar takime mjaft entuziaste me mijëra banorët të Këlcyrës, Përmetit dhe të Tepelenës, takime në të cilat ka prezantuar ekipin e kandidatëve për deputetë të LSI-së në Qarkun e Gjirokastrës. Në këtë takime z.Meta ka shprehur "kënaqësinë e veçantë që vetëm një javë nga fitorja e 23 qershorit të jem këtu dhe të ndaj të njëjtin optimizëm dhe besim në fitoren e padiskutueshme të LSI-së në Qarkun e Gjirokastrës dhe në të gjithë Shqipërinë". Lideri i LSI-së ka deklaruar se "vota për LSI-në është investimi më i mirë për të ardhmen tuaj dhe të fëmijëve tuaj. Në do t'jua kthejmë me një mbështetje për investime por edhe përfaqësimin e merituar tuajin në të gjitha qeverisjet qendrore dhe rajonale". Ai u shpreh se LSI është e vendosur tu hapë mundësi dhe hapësira të gjithë intelektualëve të Përmetit, Tepelenës dhe të të gjithë qarkut Gjirokastrë që ata të bëjnë më shumë për të afirmuar veten e tyre por edhe të ndihmojnë komunitetin e tyre. "Vota juaj për LSI-në do të thotë që ju të jeni në qendër të vëmendjes për LSI-në, në qendër të programit në punësimin, të programit tonë për gjallërimin e ekonomisë, për gjallërimin e bujqësisë, për mbështetjen e blegtorisë, për industrinë agro-përpunuese etj. Prandaj duke votuar LSI-në ju votoni për një perspektivë të re për të gjithë Shqipërinë sepse në mbajmë fjalën dhe ne jemi të përgjegjshëm për të ardhmen e vendit", u shpreh z. Meta.

Kryetari i Lëvizjes Socialiste për

Integrim, Ilir Meta, tha se qytetarët shqiptarë do të votojnë LSI-në më 23 qershor pasi është një forcë politike e cila ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në integrimin e vendit. "Qytetarët e Përmetit, Tepelenës, Gjirokastrës dhe të gjithë Shqipërisë do të votojnë për ne se ata çmojnë LSI-në si një forcë qytetare, si një forcë që është për bashkëpunim, për zhvillim dhe për integrimin e vendit. Edhe në kulmin e fushatës elektorale, edhe në kulmin e luftës politike ne arritëm, me mençuri, me urtësi dhe me këmbëngulje që të mblidhnim Parlamentin dhe të gjithë votonin tre ligjet që do t'i japin Shqipërisë në dhjetor statusin e vendit kandidat për në Bashkimin Evropian. Kjo është shumë e rëndësishme për të zhbllokuar shumë projekte dhe shumë ndihma financiare që do të ndihmojnë ekonominë e vendit dhe që do të ndihmojnë për hapjen e shumë vendeve të reja të punës. Ne jemi partia e Shqipërisë dhe të shqiptarëve, ne jemi partia e zhvillimit të vendit, ne jemi partia e paqes sociale, ne jemi partia e bashkëpunimit me çdo qytetar që kërkon të ecë më shpejt", deklaroi Kryetari i Lëvizjes Socialiste për Integrim, Ilir Meta. Z.Meta tha se LSI, në mënyrën më të qartë, ka një vizion konkret për rristurimin e ekonomisë, për të garantuar një rritje të qëndrueshme dhe afatgjatë, e cila synon stimulimin e rritjes së prodhimit të vend, uljen e importeve, rritjen e eksporteve për të pasur një ekonomi të qëndrueshme, e cila konkurren, e cila garanton vende të reja pune të qëndrueshme dhe afatgjata.

"LSI si asnjë forcë tjetër politike ka një program të qartë për punësimin. Të gjitha politikatat tona synojnë rritjen e punësimit, si ato arsimore për zhvillimin e arsimit të mesëm profesional dhe për formimin profesional, si politika e taksave njëkohësisht, sepse për ne çdo gjë duhet vënë në funksion të rritjes ekonomike dhe të rritjes së punësimit. Për ne duhet bërë çdo gjë për të vënë në lëvizje të gjitha resurset që ka vendi ynë duke u krijuar mundësinë të gjithëve që të punësohen sepse puna është dinjitet, mirëqenie, një e ardhme e sigurt dhe investimi më i mirë për të ardhmen e fëmijëve tanë. Prandaj, duke mbështetur LSI, të gjithë mbështesim Shqipërinë të eci më shpejt në rrugën e rritjes ekonomike, në rrugën e mirëqenies së familjeve të Tiranës dhe të Shqipërisë, në rrugën e punësimit të të rinjve dhe të reja, dhe natyrisht në rrugën e integritimit evropian të vendit", vijoi ai. Duke përfunduar Kryetari i Lëvizjes Socialiste për Integrim, Ilir Meta, deklaroi se fitorja e LSI-së më 23 qershor do të jetë e padiskutueshme në të gjithë Shqipërinë. Sipas tij LSI është një parti që kujdeset për njerëzit. "Fitorja jonë është e padiskutueshme më 23 qershor. Lëvizjen Socialiste për Integrim është rruga e integritimit, kjo është rruga e mbajtjes së premtimeve. LSI është një parti që kujdeset për njerëzit dhe do të kujdeset akoma edhe më shumë sepse vota e qytetarëve shqiptarë do të jetë detyrimi ynë. LSI kujdeset për të rinjtë dhe të reja sepse ata janë e ardhmja e Përmetit dhe e gjithë Shqipërisë. Ndaj detyra jonë është që tu krijojmë hapësira dhe mundësi për një arsimim më të mirë, për formim profesional e sidomos duke hapur vende të reja pune. Ne do të fitojmë më 23 qershor sepse Përmeti, Tepelena, Gjirokastra dhe e gjithë Shqipëria meriton të shkëputet nga harresa dhe varfëria. Ne do të fitojmë më 23 qershor sepse të ecim më shpejt, kërkojmë arsimim më të mirë, kërkojmë formim profesional dhe vende të reja pune", tha ndër të tjera në komunikimin e tij me mijëra qytetarët e Këlcyrës, Përmetit, dhe të Tepelenës, Kryetari i Lëvizjes Socialiste për Integrim, Ilir Meta.



### Meta: Politikës së tuneleve po i vjen fundi

Lëvizja Socialiste për Integrim, mes entuziazmit të jashtëzakonshëm, me pjesëmarrje e mijëra qytetarëve, mbajti në Pallatin e Sportit "Asllan Rusi" Konventën e saj për Qarkun e Tiranës. Në këtë takim madhështor është prezantuar i gjithë ekipi i kandidatëve të LSI-së për Tiranën. Në fjalën e tij Kryetari i Lëvizjes Socialiste për Integrim, Ilir Meta, shpalosi vizionin e LSI-së që Tirana dhe e gjithë Shqipëria të të ecë më shpejt drejt zhvillimit, të ecë më shpejt drejt Bashkimit Evropian.

"Raporti i fundit i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim e thotë shumë qartë se në tremujorin e parë ekonomia e Shqipërisë u rrit vetëm me 0.5 për qind. Pra, është shumë pranë rënies ekonomike, shumë pranë atij skenari të cilin nuk e duam por të cilin e kemi parë se si është zhvilluar në vende të tjera. Atij skenari që çon jo vetëm në zërimin e investimeve publike, jo vetëm në humbjen e vendeve të punës por edhe në uljen drastike të pagave dhe të pensioneve. Prandaj, Tiranë e para do të votojë kundër një qeverie, e cila nuk ka asnjë përgjegjësi për financat publike dhe buxhetin e taksapaguesve shqiptarë dhe nuk ofron dot asnjë perspektivë më të mirë për 24 qershorin", tha Meta.

Meta tha se "Politikës së tuneleve po i vjen fundi, sepse ajo nuk është politika e cila garanton progresin ekonomik dhe social por është një poli-

tikë afatshkurtër për qëllime elektorale e cila nuk sjell atë progres që i kanë kërkuar dhe që kërkojnë qytetarët shqiptarë. Katër vjet më parë u inaugurua tuneli i Kalimashit. Jam i bindur se këtu ka plot qytetarë nga Kukësi me origjinë dhe ata kanë familjarët e tyre në Kukës. Dhe ata e dinë shumë mirë se pas katër viteve nga inaugurimi i tunelit të Kalimashit, i cili nga nxitimi me të cilin u inaugurua, u harxhuan dhe rreth 100 milion euro më pas për ta rikuperuar. Pra që atëherë numri i familjeve në qytetin e Kukësit që marrin asistencë sociale është dyfishuar. Nesër kemi një inaugurim tjetër.

Kemi inaugurimin e tunelit të Kërrabës, i cili po inaugurohet vetëm për qëllime elektorale, jashtë gjithë standardeve teknike, duke abuzuar me fondet tuaja dhe të prindërve tuaja, vetëm e vetëm që Sali Berisha mendon se mund të marrë edhe një votë më shumë. Por përgjigjen më të mirë do ta marrë në Elbasan dhe në Tiranë ashtu si do ta marrë në të gjithë Shqipërinë. Sepse politika e tuneleve po shkatërron ekonominë tonë. Ajo ka rritur deficitin në mënyrë të jashtëzakonshme. Ajo nuk mund të sjellë më shumë punësim, përkundrazi. Ka sjellë një regres social sepse nuk është një politikë e mençur por është një politikë populiste për qëllime afatshkurtra.